



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.99/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 6000 (gjashtëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 26.09.2019, rreth orës 12:00, në Fushë Kosovë afër shkollës fillore “Mihail Grameno”, është parë i vendosur një poster i madh i kandidatës për kryeministre nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK). Paraqitësi i ankesës më tutje thekson se vendosja e posterëve në afërsi të shkollave dhe institucioneve publike është e ndaluar me ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, përkatësisht nenin 33 pika b, me rregulloret 13/2013, neni 3 pika 3.4 dhe Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike neni 4 pika b, si provë për pretendimet e tyre paraqitësi ka bashkangjitur një (1) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 27.09.2019, nuk ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke theksuar se është e pabazë, sepse në kushte dhe rrethana në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke e pasur parasysh faktin se komunitat nuk kanë arritur që ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore, vendosja në hapsirën e mbikalimit nuk do të duhej të trajtohet si shkelje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatës për kryeministre nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), është ngjitur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatës për kryeministre nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), është vendosur në objektin publik përkatësisht mbi rrugë publike. Të cilën shkelje nuk e ka pranuar subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatës për kryeministre të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu PZAP-i si rrethanë mori edhe faktin që subjektit politik LDK ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe bërë përmasimin e shkeljes, mirëpo në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre kanë mohuar se kanë bërë shkelje dhe nuk kanë marrë asnjë veprim për të tërhequr banerat nga vendi i palejuar.

PZAP-i, pasi vlerësoi pretendimet ankimore sipas kriterëve të përcaktuara më lart, konstatoi se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur neni 33, pika b) të LZP-së, pasi që nga provat e ofruara shihet qartë se baneri i kandidatës për kryeministre të subjektit të tij është vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke marrë parasysh se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk ka bërë asnjë veprim për ta përmirësuar shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike respektivisht largimin e

banerit edhe pse është urdhëruar nga PZAP-i, me parashtresën e datës 26.09.2019, që ta përmirëson shkeljen e theksuar më lart.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 3 par.2 të Rregullës Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it dhe kuptim 120.1, pika c) të nenit dhe të nenit 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 99/2019 më datën 27.09.2019.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi